



KORRUPSION

anti

ORGAN I SHOQATËS SË AVOKATËVE ANTIKORRUPSION SHQIPTAR

E përdjashme, informuese, denoncuese dhe investigative Viti I | | botimit Numri 2 28 Korrik 2014 Çmimi 20 lekë (0.5 Euro)
Adresa: Rruga: "Ibrahim Rrugova", Kompleksi "Green Park", Pallati Nr. 26 Cel.: +355 6920 20 512/612 Web: www.antikorruption.com



Ervin Dervishi, rrugori që i ka bërë rrugë abuzimet

SHKB e kallëzoi, Prokuroria e provoi, Gjykata e dënoi, Apeli e pushoi, Saimir Tahiri e emëroi

NUMRI I MERAPRSEM I GAZETES



EDITORIAL

Nga Av. Ndue Pjetra

Vendimet para 2001 janë politike, duhet gjetur mekanizmi për t'i rishikuar

Shoqata e Avokatëve Antikorruption kërkon rishikime të vendimeve të padrejta që janë bërë para vitit 2000, në mungesë të plotë të provave. Kjo është një kërkesë e vetë realitetit të sotëm juridik shqiptar, kur dihet fare mirë se në ç'kushte dhe në ç'rrethana janë dhënë ato vendime, të cilat kanë krijuar një konfuzion shumë të madh. Në atë periudhë tranzicioni të plotë, kur vendi ynë dhe së bashku me të edhe sistemi gjyqësor në Shqipëri ishte në kaos të plotë, janë dhënë vendime shpesh të pabazuara dhe të padrejta ndaj shumë të dënuarve. Kjo ka ndodhur sepse mungonte elementi bazë, që është prova. Kësisoj, mbi çështjet penale, për të cilat organi procedues e gjykata, kanë dhënë dënime pa një proces të drejtë ligjor dhe pa u mbështetur në prova Shoqata Avokatëve Antikorruption Shqiptare në zbatim të misonit të saj në ndihmë...

(Vijon në faqen 6)

Të arrestohet urgjentisht Guvernatori Ardian Fullani

Guvernatori i Bankës së Shtetit Shqiptar, Ardian Fullani, i cili është caktuar për të drejtuar dhe mbrojtur thesarin e shtetit, duhet të vihet menjëherë nën pranga, për shpërdorim të detyrës. Sepse ai me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka krijuar një terren të përshtatshëm për hajtudet e thesarit, të cilët vidhnin çdo ditë në mes të kamerave. Lind pyetja: Me çfarë është marrë Fullani gjatë këtyre viteve, kur ai nuk ka arritur të sigurojë as thesarin e shqiptarëve? Kjo vjedhje nuk ndodh për herë të parë në këtë bankë. Por grabitje të ndryshme kanë ndodhur herë pas here, të cilat sipas rastit janë toleruar, ose janë falur. Por tani nuk mban më ujë pilafi dhe Fullani duhet të përgjigjet penalisht, para Drejtësisë.



INVESTICIM

Miliarderët e kamur të sistemit të Drejtësisë që flenë sipër florinjve

Strasburgu luan 'kukamfshehti' me qeverinë shqiptare për pronat

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në procesin gjyqësor të zgjidhjes së martesës

Ja kush janë kryeministrat që e kanë drejtuar vendin nga Ismail Qemali tek Edi Rama

OSBE kundër Qeverisë për ligjin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë

Si e helmuan të dënuarën numër tre, Fiqirete Shehun në Burgun e Zeimitit

Mendime parake dhe të përgjithshme mbi Kanunin A. Zef Valentini S.J.

Shoqata e Avokatëve Antikorruption, tubim më 5 shtator për amnisti të hashashit

